



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 106
Prishtinë, më 17.9.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Halil Thaqi, Mirlinda Tishukaj, Yllza Hoti dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Bekim Arifi, Visar Korenica, Rashit Qalaj, Adem Hoxha dhe Albana Bytyqi.
Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit e tjerë: Atifete Jakupaj, MKRS, Xheladin Krasniqi, MKRS, Hajrulla Çeku, MKRS, Nora Arapi Krasniqi MKRS, Taibe Selmani MKRS, Zukë Zuka, ZKA, Mjellma Dibra Morina dhe Driada Thaqi, ZKA, Bashkim Gashi dhe Artizana Krasniqi, GP-LVV.

Mbledhjen e kryesoi: Hikmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 2.7.2024 dhe 16.7.2024;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2023.
4. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për sesionin pranveror 2024;
5. Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 2.7.2024 dhe 16.7.2024.

Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 2.7.2024, dhe 16.7.2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2023.

Hykmete Bajrami, Kryetare e Komisionit: Të nderuar, sot e kemi të ftuar ministrin Hajrulla Çeku dhe përfaqësuesit e Zyrës Kombëtare të Auditimit, deputetin raportues Hajdar Beqa. Pa e zgjatur, po ia kaloj fjalën deputetit raportues, pastaj fjala do t'i kalojë ministrit.

Hajdar Beqa, deputet GP-PDK: Siç tha edhe kryesuesja Hykmete Bajrami, sot do të shqyrtojmë raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2023. Ky raport është me opinion të kualifikuar dhe ka gjithsej 13 rekomandime; prej tyre, dy janë rekomandime të reja, 7 janë të përsëritura dhe 4 pjesërisht të përsëritura.

Baza për opinionin e kualifikuar, sipas raportit të auditorit, është se vlera e pasurive kapitale e prezantuar në pasqyra financiare vjetore ishte nënvlerësuar për 995,305 €, ndërsa e pasurive jokapitale për 41,497 €, si rezultat i mos regjistrimit dhe mos shpalosjes së pasurive. Gjatë vitit 2023, MKRS kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 135,322 € në kategori ekonomike joadekuate.

Në planin e financave vjetore, pasqyra e pranimeve dhe pagesave ishte nënvlerësuar për vlerën 36,167 € si rezultat i mosprezentimit të kthimit të donacioneve. Auditori ka konkluduar se procesi dhe transaksionet janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara, megjithatë, janë evidentuar disa probleme.

Në 19 raste, në vlerë prej 2,585,765 €, nuk ishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve siç përcaktohet në marrëveshje. Në dy raste të testuara nga auditori, me vlerë prej 849,699 €, kishte dobësi në procedurat e prokurimit. Në 9 kontrata të nënshkruara për përfituesit e subvencionit me vlerë prej 326,082 €, është identifikuar dobësi në procesin e nënshkrimit të kontratave.

Në 3 raste të testuara, me vlerë prej 163,481 €, Ministria kishte lidhur kontratë duke mos i respektuar afatet e përcaktuara me ligj. Në 4 raste, me vlerë totale prej 67,309 €, kishte vonesa në pagesa përtej afatit ligjor prej 30 ditëve. Në fund të vitit 2023, Ministria kishte avance të hapura për udhëtime zyrtare me vlerë prej 28,330 €. Të gjitha këto janë shkelje ligjore, dhe ndoshta tani ministri mund të justifikojë këtë raport shqetësues.

Dua të theksoj si jurist se disa pika të raportit sugjerojnë elemente të veprës penale dhe ndoshta ky raport është për tu dërguar në Prokurorinë e Shtetit. Faleminderit.

Hykmete Bajrami, Kryetare e Komisionit: Ministër, edhe unë kam disa pyetje, por nëse dëshironi, mund të merrni fjalën njëherë për raportin në përgjithësi.

Hajrulla Çeku, MKRS: Faleminderit dhe përshëndetje të gjithëve. Faleminderit gjithashtu Zyrës Kombëtare të Auditimit për punën dhe angazhimin e tyre. Dua të sqaroj disa mospajtime që kemi me disa nga gjetjet e ZKA-së, duke theksuar se këto kanë qenë më shumë sqarime të rrethanave dhe volumit të punës tonë sesa kundërshtime në kuptimin procedural. Më lejoni të shpreh një mospajtim me deputetin raportues Hajdar Beqa lidhur me deklaratën e tij; asnjë nga gjetjet nuk paraqet elemente të veprës penale. Ne i kemi dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme ZKA-së.

E kuptoj se ZKA-ja ka të drejtë të nxjerrë gjetje për tejkallimet, por shpeshherë përballohem me vonesa për arsye objektive, veçanërisht kur jemi të varur nga palë të jashtme. Në kontekstin e punës sonë, kemi një numër të madh projektsh investimi, përfituesish të subvencioneve dhe aplikantësh, që kërkojnë menaxhim të kujdesshëm. MKRS ka 15 institucione të varura, dhe ne përpiqemi të mbështesim të gjitha këto struktura. Kemi argumentet tona për secilën gjetje dhe veprimet që kemi ndërmarrë pas dorëzimit të planit të veprimit në ZKA. Mund t'i lexoj një nga një ose mund t'i lëmë për debat, sipas interesit tuaj.

Hajdar Beqa: Minister, unë po flas në bazë të raportit të auditorit. Edhe pse nuk i lexova të gjitha gjetjet, mund të përmend disa prej tyre, si vonesat në arsyetimin e subvencioneve, dobësitë në procedurat e prokurimit, dhe vonesat në nënshkrimin e kontratave. Të gjitha këto përmbajnë elemente të veprave penale. Ministri ndoshta nuk është jurist, ndoshta nuk e kupton përgjegjësinë.

Hajrulla Çeku, MKRS: I nderuar deputet, e pranoj se ka vonesa, por nuk arrita të kuptoj se si këto përbëjnë vepra penale. Nëse do të kishte ndonjë dyshim për veprën penale, ne do të kishim njoftuar organet kompetente. Për çështjen e subvencioneve për organizatat e shoqërisë civile, ne i paralajmërojmë ato për çdo vonesë. Një nga sanksionet që aplikojmë është se një organizatë që nuk e mbyll projektin e saj nuk merr fonde të tjera. Nëse tejkalohen afatet pas paralajmërimeve, ndodhin veprime ligjore. Këto vonesa janë zakonisht ditore apo javore.

Hajdar Beqa: A është zbatuar kjo rregullore që po e përmendni për përfituesit e subvencioneve?

Hajrulla Çeku, MKRS: Po, patjetër. Ne kemi shpjeguar edhe gjendjen tonë të kapaciteteve njerëzore në administratë. Ajo që ka ndodhur ndër vite është se mbështetja është rritur, por kapacitetet e administratës nuk janë rritur në proporcioni me rritjen e mbështetjeve. Ne përpiqemi të bëjmë më të mirën tonë për t'i evituar këto vonesa.

Hykmete Bajrami, Kryetare e Komisionit: Faleminderit shumë, ministër. Unë po e vazhdoj aty ku e la deputeti, tek çështjet për konkluzionet e pajtueshmërisë. Kam një koment dhe një pyetje për ZKA-në; nuk e kuptojmë konkluzionin e pajtueshmërisë përderisa nuk ka një konkluzion të qartë. Çështjet janë të renditura, por sinqerisht nuk e dimë nëse ZKA-ja e ka kualifikuar si të mirë apo të keqe opinionin në raport me pajtueshmërinë.

Minister, nuk janë të gjitha vonesa. Për shembull, në pikën b3) thuhet se në 19 raste, në vlerë prej 2,585,765 €, nuk janë dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e

subvencioneve. Është e qartë se ZKA punon me mostra, domethënë nuk i analizojnë të gjitha rastet e subvencioneve një nga një për shkak të kapacitetit të kufizuar.

Në dy raste të testuara, me vlerë prej 849,699 €, kishte dobësi në procedurat e prokurimit. Në raportin e ZKA-së flitet për aplikimin e nenit 54 të Ligjit për Prokurim Publik, i cili është i paaplikueshëm në këtë rast. Në pikën A2), në 9 kontrata të nënshkuara për përfituesit e subvencioneve, janë identifikuar dobësi gjatë procesit të nënshkrimit të kontratave.

Përveç kësaj, ZKA-ja thekson se në një rast, pasqyrat nuk janë dorëzuar në ATK, që tregon se është dhënë subvencion dikujt që nuk i ka përmbushur kriteret për përfitim. Gjatë mandatit tuaj, në ekzekutimin e buxhetit, në vitin 2021 janë dhënë 15.4 milionë €, në vitin 2022, 13 milionë €, dhe në vitin 2023, 22 milionë € në subvencione. Pra, për tre vite janë dhënë 50 milionë € subvencione, ndërsa investimet kapitale janë vetëm 25 milionë €. Dëshiroj të di se me çfarë indikatorësh e matni rezultatin e këtyre subvencioneve. Gjithashtu, media ka raportuar për shpërndarjen e subvencioneve për vitin 2024, duke përmendur se keni dhënë 250 mijë € për vëllain tuaj në një organizatë joqeveritare dhe për eksponentë të tjerë të Lëvizjes Vetëvendosje.

Hajrulla Çeku, MKRS: Zonja Kryetare, do të përgjigjem në rend të çështjeve që ngritët. E para ishte çështja me vonesat.

Hykmete Bajrami: Jo, nuk thashë vonesa. Thuhet se nuk janë dorëzuar raportet; nuk janë vonuar, por nuk janë dorëzuar fare.

Hajrulla Çeku: Përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve me kohë, që do të thotë se janë vonuar. Vonesat ndodhen për shkak të lëvizjeve buxhetore në linjën e subvencioneve dhe transfereve. Mjetet janë bartur me vonesë, dhe disa projekte nuk janë përfunduar në kohë, duke rezultuar në vonesa për mbylljen e avanceve.

Çështja tjetër që u ngrit ishte dobësia në aplikimin e procedurave të prokurimit. Ne besojmë se kontrata për 30% gjen zbatim në nenin 54.11, që lejon variacionet e sasive totale indikative të kontratës. Vonesa në nënshkrimin e kontratave gjithashtu ka ndodhur, por pas sigurimit të buxhetit, disa përfitues kanë vazhduar aktivitetet e tyre. Duhet një kohë e caktuar për të filluar procedurat ligjore nëse një përfitues nuk dorëzon dëshmi për realizimin e projektit.

Hykmete Bajrami, Kryetare e Komisionit: Tek çështja A1, ZKA ka thënë që neni 54 i rregullores për prokurim publik nuk aplikohet në rastin konkret, dhe kjo është konsideruar si e gjetur. Ndërsa për mospërmbushjen, nuk bëhet fjalë për mosraportim të shpenzimeve, por për dhënien e subvencioneve duke mos i përmbushur kriteret nga autoritetet, për shkak se në disa raste janë kërkuar pasqyrat që organizatat të raportojnë në Administratën Tatimore të Kosovës.

Hajrulla Çeku, MKRS: Kjo është një çështje tjetër. Ne i kemi shqyrtuar me kujdes organizatat përfituese që ZKA i ka identifikuar. Aty ku ka mundur të ketë gabime në procesin e vlerësimit, ne e kemi pranuar këtë gjetje. Ky është një mesazh për të gjitha komisionet vlerësuese, pasi ato në raste të caktuara shqyrtojnë qindra aplikime dhe dosje projektsh. Presioni kohor për të kryer punën më shpejt mund të shkaktojë pakujdesi në vlerësim. Disa nga organizatat e identifikuar nga ZKA janë serioze dhe kanë përfituar vite me radhë. Ministria jonë ka dy instrumente kryesore

mbështetjeje: investimet kapitale dhe subvencionet, të cilat shpërndahen në tri linja: institucionet e varësisë, sporti, dhe thirrjet publike.

Hykmete Bajrami: E para, pajtohem që subvencionet janë të rëndësishme, por nuk mund të relativizoj çështjen e investimeve kapitale. Të japësh 50 milion € subvencione për tre vite dhe të mos kesh ku të zhvillohet një ndeshje futbollit për shkak të kushteve të këqija të fushës, kjo nuk është për t'u krenuar. Pyetja ime është: si ka mundësi që 10 milionë € në vitin 2023, pa rishikim të buxhetit, kalohen nga kategoria e investimeve kapitale në subvencione? Gjithashtu, më intereson si ZKA nuk i ka shqyrtuar disa çështje, si tenderët njëburimorë. Pastaj, ju lutem, si u dhanë 257 mijë € OJQ-së, që e përmenda më parë?

Hajrulla Çeku: Ju lutem, zonja Atifete Jakupaj, zyrtare e Financave, do ta shpjegojë pjesën e transferimit, pastaj do të vazhdoj me çështjen tjetër.

Atifete Jakupaj MKRS: Neni 30 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë pika 1,2 dhe 3 në mënyrë decidive i spjegon rastin, kur ka të drejtë të bëhet transferi. Në rastin e tillë është shfrytëzuar pika 30, që ka të drejtë organizata buxhetore deri në 5% të masës monetare në total të kategorisë së shpenzimeve të bëjnë transferin. Të gjitha transferet, realokimet e zhvilluara gjatë vitit 2023 janë në përputhje me ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësisë dhe ligjit për buxhetin vjetor të vitit 2023 neni 16, prej pikës 1 deri në pikën 8.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Prej kur është 5% e 32 milion, 10 milion? Për 10 milionë përgjigjet diku 30% nga 32 milionë.

Atifete Jakupaj MKRS: Pjesa e parë e transfereve është bërë në bazë të nenit 30 pika 1 ku ceket 5%. Pastaj 30.2 e lejon që deri në 15% ka të drejtë të bëjë transfer ministri i financave. Pos kësaj është neni 30.3 që ministri me arsye kërkon në Qeveri që të bëhet transfer deri në 20%.

Hajrulla Çeku: Unë besoj që për çfarëdo lëvizje buxhetore nuk do të ishte e mundur të realizohet pa kaluar nëpër filtrat e Ministrisë së Financave por edhe të Qeverisë së Kosovës. Çështja ku thatë se unë i kam ndihmuar vëllait tim, unë do të lutesha mos të bëheni pjesë e kësaj shpifjeje si kryetare e komisionit. Në momentin që një shpifje e tillë ka dalë në publik dhe pa asnjë verifikim është shpërndarë në media, unë këtë çështje e kam lajmëruar në Policinë e Kosovës, Nuk i kam paditur për shpifje, por kam paraqitur rastin si pretendim të tillë.

Hykmete Bajrami, Kryetare e Komisionit: Ministër, a është e vërtetë që ju jeni themelues i OJQ-së "Ec më Ndryshe" dhe a punon vëllai juaj aty? Çfarë do të thoshte Lëvizja Vetëvendosje, nëse një ish-ministër do të bënte një gjë të tillë?

Hajrulla Çeku: Keqkuptimi që krijohet qëllimshëm është se po e barazojmë një OJQ me një biznes. Kur themelon një OJQ, je vetëm themelues, ndërsa kur je themelues i një biznesi je pronar ose aksionar i atij subjekti, që themelohet për qëllime përfitimi. Një OJQ nuk ka për qëllim të fitojë. Prej vitit 2017, nuk kam asnjë angazhim në Organizatat e Shoqërisë Civile. Sa i përket stadiumit "Fadil Vokrri", ne jemi akoma duke punuar aty; puna nuk ka përfunduar ende.

Hykmete Bajrami: Kam respekt për të gjitha OJQ-të dhe punën e tyre, por jam e sigurt që të gjithë që punojnë aty, përfshirë ju, jeni paguar më shumë se çdo gazetar që ka raportuar për ju. Nuk mund ta anashkalojmë faktin që jeni pjesë e një Qeverie, një partie që për 15 vitet e fundit ka akuzuar të tjerët për tradhti.

Hajrulla Çeku: Ju lutem, mos e përhapni një paragjykim. Nuk është e vërtetë që kanë paga të larta; ndoshta ka përjashtime, por janë njerëz të ndershëm që punojnë.

Hajdar Beqa: Sa i përket stadiumit "Fadil Vokrri", ekspertët e kanë vlerësuar se problemi kryesor ka qenë bari sintetik hibrid. Vlera në treg dhe buxheti për këtë janë të rëndësishme. Pajtohem që ministria nuk ka rol të drejtpërdrejtë, por në kontratën një burimore, ministria ka rol. Sa i përket subvencioneve, mund të ketë pasur mundësi për një konflikt interesi, siç e përmendi edhe kryetarja, e cila iu referua mediave.

Hajrulla Çeku: A mund të më tregoni një emër të një eksperti që ka thënë se është problem bari në stadium?

Hajdar Beqa: Emrat janë në letër, ju lutem më tregoni, a e keni shkëlur ligjin duke bërë kontratë një burimore për mbjelljen e barit? Ajo punë nuk është një nevojë e jashtëzakonshme?

Hajrulla Çeku: Po të ishte kjo çështje e barit ashtu siç po e reduktoni, nuk do të kishte ardhur puna fare tek kjo kontratë, sepse do të ishte rregulluar me masa të tjera, që është çështje e thjeshtë mirëmbajtjeje. Çka ka ndodhur është se fusha e vetme ku ka qenë e mundur të mbahet një ndeshje ndërkombëtare është degraduar në masë pa kthim, dhe loja me Izraelin në fund të vitit ka qenë dëshmia më e mirë që aty duhet të veprojmë shpejt. Ky stadium është në përgjegjësi të Komunës së Prishtinës dhe komuna nuk e ka marrë shumë parasysh këtë ngjarje. UEFA-ja ka dërguar disa operatorë, dhe, i nderuar deputet, edhe ju po të ishit në pozitën time do të mundoheshit të kryeni punën në mënyrë sa më efikase kur është në pyetje reputacioni i shtetit.

Hajdar Beqa: Ministër, thatë që UEFA ka dërguar disa operatorë. Sa operatorë kanë dërguar dhe a i keni dërguar njoftimet për të gjithë apo vetëm njërit?

Hajrulla Çeku: Për këtë ne kemi qenë në kontakt me Federatën e Futbollit, sepse autoriteti profesional për futbollin në këtë vend është kjo Federatë. Ata kanë qenë në komunikim dhe në dijeni për këta operatorë. Me njërin prej tyre kanë pasur komunikim për paramasë se sa mundet të kushtojë ky investim, dhe ne kemi shkuar me operatorin që ka kryer më së shumti punë në këto vitet e fundit. Dokumentet janë publike, kontrata është aty, mund t'i shihni.

Mirlinda Tishukaj (GP-LVV): Unë e them publikisht që nëse është dikush që ka punuar shumë për sportin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore, është pikërisht ministri Çeku. Jam shumë krenare që e kam edhe kolegë të subjektit tim politik. Ai ka krijuar politika të reja, si politika e re Drejt Malit, ka zhbllokuar stadiumin e Gjakovës, stadiumin Adem Jashari, stadiumin e Gjilanit, dhe ka bërë kallëzim penal për humbjen e një aseti të trashëgimisë kulturore në Prizren. Kemi zbulime të reja tek Ulpiana për të vërtetuar autoktoninë tonë. Ka kryer shumë punë në dobi të të gjithave që i përmenda. Ministër, a mund të na tregoni sa kallëzime penale keni bërë deri tani?

Po ashtu, do të dëgjoj edhe mendimin e ZKA-së për raportin. Kërkoj edhe një herë nga z. Zuka, sepse u bë bujë këtu. Në raport, keni thënë që përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Andaj, nëse e përkthejmë në gjuhën popullore, do të thotë që nuk ka dyshime për vepra penale, por të gjitha transaksionet janë bërë në bazë të ligjit. Z. Zuka, a na e konfirmoni një çështje të tillë?

Ministër, po ashtu, ju përgëzoj që më në fund iu dha epilog edhe Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyçi”. Kjo kishte qenë mostër edhe e ZKA-së dhe është evidentuar bartja e pronësisë. A e keni adresuar këtë aspekt? Po ashtu, më intereson te çështja që nuk jeni pajtuar, na e sqaroni pse nuk jeni pajtuar. Kam edhe një çështje që ka të bëjë me ndërtimin e dy projekteve: ndërtimi i varrezave në kompleksin memorial në Kleçkë. Çka ka ndodhur me ndërtimin e obeliskut të Radio Kosovës së Lirë dhe bunkerit në kompleksin memorial Shtabi i Përgjithshëm në Kleçkë dhe Divjakë, Malet e Berishës? A janë realizuar deri në 40%, a janë kushtet atmosferike apo mungesa e buxhetit?

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ministër, po ndërhy këtu. Sipas memorandumeve që kam parë mes MKRS dhe Komunës së Suharekës, ky memorandum është lidhur në vitin 2020. Andaj, duke pasur parasysh se ai vit ka qenë vit i pandemisë, bie që vonesat kanë ndodhur në mandatin tuaj.

Hajrulla Çeku: Procedura për këtë projekt ka filluar në vitin 2017. Ka pasur shkëputje të kontratave dhe unë këtë kontratë e kam gjetur të lidhur. Memorandumi ka pasur për zgjatje të afateve. Zhbllokimi ka ndodhur vitin e kaluar, kur OSHP-ja e ka dhënë vendimin përfundimtar dhe i ka dhënë të drejtën komunës ta japë këtë kontratë operatorit, dhe ne pastaj jemi mobilizuar me financa.

Sa i përket regjistrimit dhe raportimit të pasurive, është zbatuar ky rekomandim i auditorit, dhe kemi edhe raportin e SIMFK me status të ri. Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyçi” në Suharekë, e kemi inauguruar mbrëmë; ky ka qenë një projekt i zvarritur me vite. Te agjencia e memorialëve, çdo rast është specifik. Një rast është zhvarrosje dhe rivarrosje, dhe rasti tjetër lidhet me kushtet atmosferike dhe disa detaje të tjera që nuk kanë mundur të parashikohen në projekt, sidomos kjo vlen për restaurimet në trashëgiminë kulturore. Kur janë objektet e vjetra, gjatë ndërhyrjeve zbulohen edhe shtresa të reja, të cilat krijojnë kosto shtesë.

Sa i përket kallëzimeve penale, kemi një shifër të saktë, por mund të them se vetëm inspektorati ynë i trashëgimisë ka dërguar dhjetëra kallëzime. Ndërsa për kallëzimet që unë kam dorëzuar, kryesisht për parregullsi financiare, ato janë rreth 20. Po ashtu, kemi iniciuar një numër të madh procedurash disiplinore për dyshimet që kemi pasur për stafin brenda.

Zukë Zuka: Faleminderit të gjithëve për vlerësimin ndaj ZKA-së. Bashkëpunimi ynë me Ministrinë ka qenë shumë i mirë. Tani për t’u përgjigjur pyetjeve, sidomos pyetjes së kryetares lidhur me konkluzionin e auditimit, dua të sqaroj se konkluzioni i auditimit në raportin tonë konsiderohet i kualifikuar për arsye se konkluzionet bazohen në kriteret, rregulla që janë të shkruara në ligje apo udhëzime të tjera.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Unë nuk shoh kualifikim për konkluzionin e pajtueshmërisë. Baza e opinionit të raportit është shumë e rëndësishme. Raporti thotë se të gjitha transaksionet janë në përputhje me rregullat, siç e citoj Mirlinda. Përveç çështjeve të ngritura, baza për konkluzion përmban disa shifra të mëdha: A1 - 849 mijë euro, B1 - 2.6 milion euro, A2 - 326 mijë euro, C2 - 163 mijë euro, C3 - 76 mijë euro, dhe B4 - 28 mijë euro. Sa e gjatë do të kishte qenë kjo listë që ju të thoni se transaksionet nuk kanë qenë në pajtueshmëri me rregullat ligjore? Andaj, po them që do të ishte mirë të kishit një kualifikim të opinionit për pajtueshmëri, sepse këtu flasim për disa miliona euro të cekura. Si mund të thuhet që janë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi?

Zukë Zuka: Atë desha të sqaroj se duhet të bëjmë një dallim. Opinioni që e japim për pasqyrat financiare ka të bëjë me vlerat financiare, ndërsa konkluzioni i pajtueshmërisë ka të bëjë me pajtueshmërinë me ligjin. Konkluzioni i pajtueshmërisë, kur paraqitet në raportin e auditimit, është i kualifikuar sepse është në harmoni me ligjet dhe rregulloret. Sa i përket opinionit financiar, ne e bazojmë atë në materialitet. Nëse paraqesim disa të gjetura që e kalojnë materialitetin, ato ndikojnë në opinionin. Po ashtu, ne punën tonë e kryejmë me mostra; kjo është mëse e vërtetë. Kur e paraqesim numrin e mostrave në raport, i paraqesim vetëm ato që janë me gjetje. Sa i përket testimit të tenderëve njëburimor, ku u përmend stadiumi, ju e dini që ZKA-ja ka paraqitur edhe një raport të performancës lidhur me stadiumin, ku janë të përfshira të gjitha çështjet e përmendura. Edhe këtë vit ka pasur mostra ku janë testuar transaksionet, duke pasur parasysh edhe tenderët njëburimorë.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Në rregull, faleminderit auditor. A ka dikush ndonjë pyetje? Nëse jo, atëherë faleminderit për prezencën. A ka ndonjë propozim për adresimin e këtij raporti?

Hajdar Beqa: Si deputet raportues, propozoj që për shkak të gjetjeve dhe opinionit të kualifikuar, raporti të adresohet për shqyrtim në seancë.

Përfundim

Propozimi i deputetit raportues, që Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2023, të adresohet në seancë plenare për shqyrtim, nuk i mori votat e duhura, nga anëtarët e KMFP-së.

4. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për sesionin pranveror 2024

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ky raport është raport standard të cilin administrata e përgatit për secilin sesion të punës. Në këtë raport janë të dhënat dhe aktivitetet e përgjithshme që ka pasur ky komision. Pra komisioni gjatë periudhës janar-korrik, ka mbajtur 15 mbledhje të

rregullta. Kemi pas në shqyrtim 63 pika. Pra i përfshin gjitha çështjet e shqyrtuara dhe raportimet në komision. A ka dikush diçka për të plotësuar këtë raport, apo ta hedhim në votim.

Përfundim

KMFP, miratoi Raportin e Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për sesionin pranveror 2024

5. Të ndryshme

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Pasi mbetem pa kuorum, nuk mund të votojmë për pikat e mbetura. Por, po e diskutojmë mbledhjen e radhës. Mirlinda e ka një propozim për një raport. Unë kam menduar që ta ftojme ministrin e Financave për RVA, të cilin duhet ta përfundojmë brenda tetorit, edhe pse ende kemi kohë. Një çështje tjetër, që ne si komision e kemi obligim në bazë të nenit 98, të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është shqyrtimi i raporteve, të auditimit, për Agjencitë e pavarura që i raportojnë Kuvendit. Andaj në mbledhjen e radhës po i caktojmë disa nga këto raporte për shqyrtim.

Me kaq e mbyllim takimin për sot.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit